


TË RINJTË dhe INTEGRIMET

# Integrimet evropiane dhe euro-atlantike



## Çfarë është integrimi evropian?

Në rastin e integrimit evropian, pjesët (e sistemit) që integrohen janë shtetet kombëtare. Ajo që shtetet humbasin gjatë procesit të integrimit evropian është sovraniteti, që do të thotë se për një numër të konsiderueshëm çështjesh, vendimet nuk mund të merren më prej qeverive të shteteve kombëtare, por prej institucioneve të Bashkimit Evropian. Ndërsa ajo që shtetet kombëtare fitojnë gjatë integrimit evropian është solidariteti, i kuptuar si treg i përbashkët, mbrojtje e përbashkët, monedhë e përbashkët, politikë bujqësore e përbashkët etj.

## Çfarë është Bashkimi Evropian?

Bashkimi Evropian është një organizatë ndërkombëtare me karakter mbikombëtar, brenda së cilës shtetet anëtare janë të lidhura me interes të përbashkët në fusha të ndryshme. Bashkimi Evropian (BE) është familje e shteteve demokratike evropiane, që punojnë së bashku për të përmirësuar jetën e qytetarëve të vet dhe për të ndërtuar një botë më të mirë. BE nuk është shtet federal si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pasi që vendet anëtare të tij mbeten shtete të pavarura; por as nuk është organizatë ndërqeveritare sikur Kombet e Bashkuara, pasi që vendet anëtare japin pak nga sovraniteti i tyre dhe rrjedhimisht marrin më shumë fuqi dhe influencë kolektive se që ata do kishin nëse do vepronin në mënyrë individuale. Ata e bashkojnë sovranitetin e tyre duke marrë vendime të përbashkëta për mes institucioneve të përbashkëta.

Fillimi i procesit të integrimit evropian e ka zanafillën e vet në 9 maj të vitit 1950, kur Ministri i Jashtëm francez, Robert Shuman, paraqiti propozimin e tij për krijimin e një bashkësie e cila do të qëndronte mbi kombet e ndryshme, një Evropë të organizuar, të domosdoshme për ruajtjen e marrëdhënieve paqësore mes shteteve anëtare të saj. Propozimi i njohur si "Deklarata Shuman" konsiderohet si hapi i parë drejt integrimit evropian dhe 9 maji është deklaruar si Dita e Evropës.

## Ç'është NATO?

NATO (North Atlantic Treaty Organisation) është organizatë ushtarako-politike të cilën e përbëjnë 28 shtete të Evropës dhe Amerikës Veriore. NATO, që ndryshe quhet edhe Aleanca e Atlantikut Verior, është themeluar në vitin 1949, si marrëveshje e atëhershme e shteteve të bllokut perëndimor. Menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Evropa u gjend e ndarë në dy blloqe ideologjike: në bllokun kapitalist dhe atë komunist, nën ndikimin e Bashkimit Sovjetik. Derisa Moska gjatë vitit 1945 - '46 pjesërisht është përmbajtur nga veprimtaria e hapur politike në shtetet në të cilat kishte ndikim, gjatë viteve 1947 - '48 u bë e qartë se ushtria sovjetike, jo vetëm që nuk kishte ndërmend të tërhiqej, por qëllimi i saj ishte që të vazhdojë më tutje.

Fillimin e krijimit të NATO-s e shënon Marrëveshja e Brukselit, të cilës më 17 mars 1948 i bashkohen Belgjika, Franca, Luksemburgu, Holanda dhe Britania e Madhe. Qëllimi kryesor i kësaj marrëveshjeje ishte zhvillimi i sistemeve të përbashkëta të mbrojtjes dhe forcimi i lidhjeve në mes këtyre shteteve, në mënyrë që të bashkuar t'u rezistojnë kërcënimeve politike dhe ushtarake ndaj sigurisë se tyre nacionale. Të

vetëdijshëm se kapacitetet e tyre ekonomike dhe ushtarake nuk ishin të mjaftueshme që t'i mbrojnë nga kërcënimet Sovjetike, këto shtete menjëherë filluan negociatat me SHBA dhe Kanadanë, me qëllim të krijimit të një aleance të re ushtarake, e cila do të bazohej në obligimet e përbashkëta dhe kufij të sigurt të Evropës dhe Amerikës së veriut. Shtetet nënshkruese të marrëveshjes së Brukselit, ftuan Danimarkën, Islandën, Italinë dhe Portugalinë që t'i bashkoheshin këtij procesi. Dymbëdhjetë shtete nga njëra dhe tjetra anë e Oqeanit Atlantik, më 4 prill të vitit 1949 e nënshkruan në Uashington Marrëveshjen e Atlantikut Verior, duke krijuar aleancën me qëllim që t'u kundërvihen kërcënimeve nga pjesa e botës komuniste dhe të ndalojnë zgjerimin e komunizmit në pjesët tjera të Evropës. Shtetet nënshkruese u obliguan se do të organizojnë mbrojtje të përbashkët në rast agresioni ushtarak në cilindo shtet anëtar (Neni 5). Në këtë mënyrë u krijua Aleanca e Atlantikut Verior (NATO).



Kërcënimet ndaj sigurisë në ditët e sotme ndryshojnë nga ato të periudhës të Luftës së ftohtë. Sot dukshëm është zvogëluar rreziku nga konfliktet tradicionale ushtarake dhe përdorimi masiv i armëve të rënda, mirëpo në anën tjetër janë shfaqur sfida të reja të cilat tek të gjitha vendet anëtare krijojnë pasiguri dhe shqetësime të cilat kërkojnë përgjigje të adekuata.

Detyrat e reja të NATO-s janë: lufta kundër terrorizmit, prodhimit dhe përhapjes së armëve për zhdukje masive, si dhe lufta kundër rreziqeve të ndryshme të cilët vijnë nga të ashtuquajturat "shtete jostabile".

Viteve të fundit NATO po ndërton mënyrat e luftës kundër rreziqeve bashkëkohore të cilat kërcënojnë sigurinë dhe stabilitetin global. Menaxhimi me krizën ("crisis management") dhe operacionet për ruajtjen e paqes ("peacekeeping" dhe "peace-support") janë disa nga mënyrat e veprimit të aleancës bashkëkohore Veriatlantike, si përgjigje ndaj sfidave të reja.



QEVERIA e MALIT të ZI

UNITED IN EUROPE,  
SAFE IN NATO.KOHA  
Favore